

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Harta e re që “ndezi” protestat, Mazniku: Asnjë shërbim nuk cenohet! Boçi: Ndarja e bashkive, për llogari të PS – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/harta-e-re-qe-ndezi-protestat-mazniku-asnje-sherbim-nuk-cenohe-t-boci-ndarja-e-bashkive-per-llogari-te-ps/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 17:51:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 17:49:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f672974c2ab2a7bcd017bb2a39251b54d8c8523c52461ca888b76972da6ffb29
TEKSTI	65347c32b93c76ecf751b7186ac84f691e656ed24b88c6e6218ba028f35416aa
PAMJA	711339c4ec5c53086f6ca64e217327d6d1946e723f80b7d7fb72566d2564a4ba

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2b1cee395e4970e193e8e96903690b44d98e38110c65c21a4f28e44e12476a78
E MËPARSHMJA	d05aae10841bc4adeec0dbf967f42835ae770c0dec918858c5c520622f66c1
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2b1cee395e4970e193e8e96903690b44d98e38110c65c21a4f28e44e12476a78>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Propozimi i socialistëve për hartën e re territoriale, e cila shkrin 15 bashki ka shkaktuar debate jo vetëm mes aktorëve politikë por edhe mes përfaqësuesve të pushtetit lokal, qytetarëve si dhe përfaqësuesve të bizneseve të cilët preken nga këto ndryshime.

Më 30 korrik, dita e fundit e sesionit parlamentar, mazhoranca depozitoi ndryshimet ku nga 61 bashki numri u ul në 46. Por pa u bërë ende 24 orë nga depozitimi i propozimit, nisi opoenca qytetare, me protesta fillimisht në Divjakë, për tu shtrirë më pas edhe në Maliq, Klos, Përrenjas, Dimal e Poliçan, ku qytetarët kundërshtuan ndryshimet, me pretendimin se do të privoheshin shërbimet e kësisoj do të niste dhe fenomeni i migrimit brenda vendit.

Debatet kaluan edhe tek mbledhjet e këshillave bashkiakë. Nga një anë ishin përfaqësuesit opozitarë, të cilët këmbëngulnin se institucionet vendore duhet të shprehin qëndrimin kundër, ndërsa nga ana tjetër socialistët dukeshin të paqartë.

Përfaqësues të këshillave bashkiakë të disa prej bashkive të prekura, shpjegojnë arsyet se përse kjo reformë e re dëmton banorët, duke nisur nga shërbimet arsimore, tek ato shëndetësore e kështu me radhë.

“Në qoftëse do të ikë dhe Bashkia, do shkojnë në Elbasan, atëherë shpresa ka vdekur, për të gjithë popullin që ka ngelur aty. Mungesa e sistemit të vadijes, e rrugëve të fshatrave, e pastrimit të kanaleve kulluese ka arritur deri në atë pikë që kanë humbur shpresat njerëzit. Kjo vjen në të gjithë format edhe për turizëm, por edhe për bujqësi sepse po nuk pati bujqësi

Romani Meta ishte një lojtar në politikë, por e “përpiu” pushteti

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

nuk ka as turizëm”, tha Ilir Paja, anëtar i Këshillit Bashkiak, Belsh.

“Cenon së pari vendimmarrjen, së dyti shërbimin ndaj qytetarëve, së treti qytetarët nuk janë më të përfaqësuar, pasi nuk do të kenë më këshillin bashkiak. Pasi nuk do të kenë titullarin. Ne jemi shoqëri, e cila duam që t’a takojmë kryetarin. Një ndër elementët e cila ne nuk jemi të gatshëm për t’u bashkuar pasi ne nuk kemi infrastrukturë rrugore. Imagjinojeni fshatin Ketë, pa asfalt. Se si mund të shkojë një qytetar, një banor nga Keta për të marrë një shërbim në Burrel. Nëse do të ishin plotësuar kriteret, edhe ato më minimalet, më baziket. Pra të kishte një rrugë, të kishte një kanal vaditës, të kishte një sistem uji të pijshëm, natyrisht që po të ishin plotësuar të gjithë këto kriterë edhe distanca midis fshatit Ketë edhe bashkisë së Burrelit është kohë shumë e gjatë dhe banori nuk mund të marrë shërbimin me një kosto kaq të madhe”, tha Albert Çollaku, anëtar i Këshillit Bashkiak, Klos.

Në të njëjtën linjë qëndron dhe opozita. Bashkëkryetari demokrat i Reformës Territoriale, Luçiano Boçi, i cilëson këto vendime të të majtëve si një déjâ vu të reformës së vitit 2014, ku sipas tij u pa qartë se shërbimet nuk vijuan njësoj.

“Nuk ka kryetar të zgjedhur që dikush ti kërkojë llogari në bazë të votës që e ka mbështetur apo s’e ka mbështetur nuk ka rëndësi fare. Nuk ka përgjegjësi të shënuara, nuk ka buxhet, nuk ka autonomi që të shpërndajë fonde dhe nuk mund të ofrojë shërbime cilësore ajo, sepse nuk ka një paketë shërbimesh që i atashohen. Formalisht mund t’ia japë bashkia, por kur s’ke buxhet...”, u shpreh Luçiano Boçi, bashkëkryetar i PD i Reformës Territoriale.

Por teksa ka kaluar më shumë se një muaj nga propozimi i ri, socialistët nuk tërhiqen. Hartuesi i reformës territoriale, socialisti Arbjan Mazniku qartëson se asnjë prej shqetësimeve të banorëve nuk ka vend në realitet, pasi bashkitë e shkrira do të funksionojnë njësoj, por si njësi administrative.

“Ndërkohë që qytetarët nuk kanë asnjë arsye të shqetësohen pasi asnjë shërbim, asnjë shërbim i cili sot i ofrohet në njësinë e tyre administrative apo në Bashkinë e sotme, nuk do ti ofrohet në qytetin që krijohet me ligjin e ri. Ligji i ri krijon bashki, krijon qytetet dhe njësitë administrative. Çdo shërbim që i duhet qytetarit për të shkuar tek dera e institucionit, do të ofrohet aty ku është edhe sot”, deklaroi Arbjan Mazniku, bashkëkryetar i PS i Reformës Territoriale.

Madje për socialistët shkrirja me Bashkitë e mëdha sjell më tepër mundësi për zonat më të vogla.

“Ne jemi nis me një reformë nga këshillimi që kemi që qytetarët të marrin shërbime më të mira. Që investimet në terren të bëhen më të mëdhaja dhe më efiente. Që punët publike të administrohen në mënyrë më të mirë dhe të krijohet një ekonomi shkalle që të na japë mundësi që pastrimin ta bëjmë më mirë, mirëmbajtjen e shkollave ta bëjmë më mirë, pastrimit e kanaleve kulluese dhe vaditëse dhe atë të territorit ta bëjmë më mirë. Këto janë të gjitha punët që bëhet më mirë nga bashkimi”, deklaroi Mazniku.

Por demokratët kanë një qasje ndryshe.

“Bashkohet Tepelena me Memaliajn, mbi bazën e kujt kriteri? Është pyetja ime. Kush i caktoi kriteret? Kriteret do i përcaktonte analiza e 2014-ës që ka të bëjë me sipërfaqen, me numrin e popullsisë, ka të bëjë me

gjeografisë, ka të bëjë me historinë dhe identitetin. Dhe në fund fare ka arsye fiannciare që këta e sjellin si kryefjalë. Dhe thonë që bashkitë që nuk performojnë mirë duhet të bashkohen me Bashkitë që performojnë mirë ose Bashkitë që mbledhin të ardhura vendore shumë duhet të fusin në gjirin e tyre ato që nuk mbledhin. Por Tepelena me Memaliajn janë të dyja të varfëra. Si mund të bëhen dy të varfëra në një të pasur?”, nënvizoi Boçi.

Nuk munguan as akuzat politike. Mazniku pretendon se propozimi i demokratëve për 100 bashki është manovër për rritje të punësimeve në administratë, ndërsa Boçi thotë se harta e re ka qëllime elektorale.

“Të jemi të sigurtë me publikun nëse synimi këtu është të shtojmë disa zyra bashkie thjesht që të mbajmë disa njerëz në punë në bashki, atëherë krijojmë 200 ose 300 bashki dhe thjesht nuk i ofrojmë shërbime kujt. Synimi është të ofrojmë shërbime për qytetarët, të mirëmbajmë rrugët, të ndriçojmë qytetin, të pastrojmë, mirëmbajmë shkollat, të krijojmë ekonomi për territorin, në atë moment na duhet të krijojmë bashki të forta që kanë kompetenca të mirëfillta. Nëse ne kemi bashki me pak njerëz, me pak bazë fiskale dhe me pak kapacitete njerëzore këto bashki nuk do të kenë mundësi të bëjnë punën që bëjnë”, shtoi Mazniku.

“Për arsye elektorale. Siç është bërë 2014-2015-ta këtë pamje dhe fytyrë ka 2026-ta. Në një situatë parazgjedhore, duhet një kontroll më i përqëndruar dhe centralizues duke ruajtur atë që ne donin të hiqnin. Dhe e gjitha kjo bëhet që të përdoret pushteti lokal siç është përdorur, jashtë funksionit të tij, si magazinë votash për pushtetin qendror. Ky ka qenë fokusi i PS-së që në momentin që nisi komisioni dhe e paralajmëruar nga ne. Instituiam që të kishim një produkt konsensual. Shfrytëzuan momentin kohor të agjendës së komisionit”, u shpreh Luçiano Boçi.

Verdiktin final e ka Kuvendi, pasi për miratimin e reformës së re territoriale kërkohen 84 vota. Megjithatë mazhoranca është e qetë, pasi në parlament ajo i ka votat e nevojshme për ta miratuar.

Në Shqipëri, në tre dekadat e fundit janë bërë dy herë ndryshime që prekin territorin. E para ishte ajo e vitit 2000 e cila vendosi formimin e 12 qarqeve, të cilat aktualisht funksionojnë edhe sot si dhe 36 rretheve me 373 bashki.

Këto vendim u ndryshuan me reformën e vitit 2014, e cila u realizua vetëm me votat e socialistëve. Vendi u nda në vetëm 61 bashki.

Sot, shumica dhe opozita kanë një mundësi që t'a finalizojnë reformën me kompromis, por deri më tani marrëveshja mes tyre duket e pamundur.

/vizionplus.tv

#Boçi

#Mazniku

#Reformaterritoriale

#VizionPlus






Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

| Më shumë video



VIDEO

"Nuk po na lejohet të marrim nga qesja..."**Xhuljana
Zhuleku**Dje
21:49

VIDEO

"Të dëgjojmë dhe të trajtojmë çdo..."**Xhuljana
Zhuleku**Dje
20:03

VIDEO

**Reforma Territoriale,
Rama takim në Bera...****Xhuljana
Zhuleku**Dje
19:44

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE

**Lajme**

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.